



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 276/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në seancën e panelit të mbajtur me 18.10.2013, mori këtë:

### V E N D I M

**Konstatohet e tërhequr ankesa** me numër: Anr.251/2013, e datës 11.10.2013, të parashtruar në PZAP nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

### Arsyetim

PZAP, me datë 17.10.2013, ka pranuar një kërkesë për tërheqjen e ankesës me numër: Anr.251/2013, të datës 11.10.2013, të parashtruar në PZAP, kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), në të cilën kërkohet që të tërhiqet ankesa e lartpërmendur nga shqyrtimi në qoftë se e njëjta nuk është shqyrtuar deri në momentin e paraqitjes së kërkesës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës së sipërshënuar, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos të shqyrtohet ankesa në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 276/2013 më datën 18.10.2013

Kryesuesi i Panelit  
Nehat Idrizi,

